

FJALA E DEPUTETES ANILA DENAJ

E ENJTE 28 PRILL 2022

E nderuara drejtuese e seancës,

Të nderuar deputetë,

Të dashur qytetarë,

Sot ratifikojmë në parlament një marrëveshje huaje, të nisur kohë më parë, në janar të vitit 2021, ndërmjet Republikës Federale të Gjermanisë dhe Republikës së Shqipërisë, për një bashkëpunim financiar në fushën e energjisë, pjesë e një programi të qeverisjes, e cila si objektivi të sajin ka mbështetjen që Shqipëria të jetë eksportuese neto e energjisë në të gjithë rajonin. Siç e thashë pak më parë, ky objektivi nuk është vendosur sot, por kohë më parë. Është vendosur pas një pune shtatëvjeçare për të menaxhuar humbjet dhe për të rritur efektivitetin.

Sot dëgjuam edhe përfaqësuesin më të lartë të ERE-s, që nëpërmjet raportit të Entit Rregullator vërtetoi me shifra faktin se efektiviteti në menaxhimin e humbjes vijon, edhe në krahasim me 2020-2021-shin, duke përmendur uljen nga 21,48 % të humbjes në 2020-ën, në 20,62 % në 2021-shin. Objektivi për ta bërë Shqipërinë eksportuese neto të energjisë nuk u vendos në momentin e parë, pas daljes nga pandemia, kur kriza e energjisë sapo filloi të artikulohej në shumë vende, por artikulimi i plotë dhe i qartë ishte nga qeverisja “Rama”, me një mbështetje të plotë financiare për konsumatorin, për institucionet përgjegjëse, për të siguruar furnizim të plotë, një furnizim i cili, për 93 mijë biznese të vogla dhe për më shumë se 700 mijë qytetarë, nuk do të rritet.

Sigurisht, ky objektivi për ta bërë Shqipërinë eksportuese neto të energjisë lidhet ngushtësisht me burimet tona natyrore. Në fakt, ne jemi një vend i bekuar, me shumë lumenj e me shumë diell, por që nuk i kemi shfrytëzuar totalisht burimet tona. Furnizimi me energji nëpërmjet të gjithë impianteve, që lidhen me shfrytëzimin e burimeve ujore, në radhë të parë na kujton atë kohë të qeverisjes demokratike, kur shumë licenca hidrocentralesh, të dhëna ca me kriter e ca pa kriter, merreshin e tregtoheshin si mall që nuk kishte zot shtetin, por individin, në kërkim të investitorëve strategjikë pasi ishte marrë licenca, në këmbim të një fitimi.

Objektivi i shndërrimit të Shqipërisë në prodhuese neto të energjisë nuk lindi as në momentin më të fundit të situatës së krijuar nga kriza në Ukrainë, pasi edhe një herë qeverisja tregoi përgjegjshmëri dhe mbështetje të plotë ndaj qytetarëve. Si rezultat i krijimit të kësaj situatë të fundit, të gjitha vendet e Bashkimit Europian e rritën faturën mujore me 20% - 40%, por megjithatë, familjet dhe biznesi i vogël, siç e thashë pak më parë, nuk ndjenë asnjë efekt. Nëse çmimi i importit është pesëfishuar, duke shkuar nga 52 euro për megavat orë në 250 euro për megavat orë, por disa herë edhe deri në 500 euro për megavat orë, këtë diferencë familjet shqiptare nuk e kanë ndjerë. Ndërkohë, sigurisht që buxheti i shtetit e ka ndjerë, me një garanci në shumën e 280 milionë dollarëve, të cilat janë mburojë për sektorin e energjisë elektrike, në mënyrë që kjo krizë globale të mos ndikojë drejtpërdrejt te qytetari, tek ai që ka të ardhurat më të ulëta, si dhe te biznesi i vogël.

Për të mos qenë të varur vetëm nga prodhimi i hidrocentraleve, por të siguruar energji nga ato burime natyrore që përmendëm pak më parë, puna e qeverisë nuk ka nisur dje për ta diversifikuar prodhimin e energjisë. Të dyja koleget pak më parë përmendën diversifikimin e energjisë. Këto sot nuk janë projekte, por janë fakte dhe investitorët strategjikë nuk gjenden pas fakteve, por janë gjetur më parë në marrëveshjet e lidhura si me partnerët strategjikë të SHBA-ve, por edhe me shtetet e BE-së. Dua të përmend këtu në veçanti dy parqet fotovoltaike, atë të Karavastasë dhe të Spitallës, të cilat janë në proces të ndërtimit dhe të prodhimit të energjisë diellore. Po vij më tej me marrëveshjen e realizuar për Skavicën dhe TECin e Vlorës.

Duke qenë edhe deputete e qarkut të Vlorës, jam shumë e kënaqur që më në fund ky TEC do të vihet në shfrytëzim në një kohë optimale. Dua të kujtoj këtu për të gjithë se qeveria shqiptare vazhdon ta paguajë kredinë, edhe pse nuk u vu kurrë në punë për shkak të projektimit të gabuar të sistemit ftohës, ndërsa tani është kthyer në një nga projektet kryesore jo vetëm për Shqipërinë, por edhe për të gjithë rajonin. Porti i lundrueshëm në gjirin e Vlorës, që do të furnizojë TEC-in dhe lidhja e tij me gazsjellësin TAP nëpërmjet tubacionit FierVlorë, do ta shndërrojë Shqipërinë në një qendër të shpërndarjes së gazit të lëngshëm drejt rajonit, por edhe Europës, duke ulur varësinë nga gazi rus dhe duke kontribuar kështu në sigurinë energjetike.

Të nderuar deputetë,

Po i kthehem diskutimit të marrëveshjes së huas për rehabilitimin e hidrocentralit të Fierzës, gjendja teknike e të cilit është thënë, ka shumë kohë, ka 39 vjet që s'ka ndikim, kjo edhe për faktin e mosreagimit në kohë optimale. Sigurisht, kjo mbështetje huaje nga Republika Federale e Gjermanisë do

të sjellë një reduktim të kapacitetit të humbjeve prej 4% në vit, sepse është një humbje që shkon në 2,6 milionë euro. Për më shumë, mungesa e kësaj energjie do të ndikojë në mënyrë të drejtpërdrejtë në rritjen e çmimit, nëse KESH-i do t'i drejtohet tregut rajonal. Nga pikëpamja strategjike, projekti do të ndikojë për përmirësimin e sistemit elektroenergjetik, sepse hidrocentrali i Fierzës përbën njësinë gjeneruese, ndër tri më të rëndësishmet në sistemin elektroenergjetik shqiptar, dhe luan rolin e rregullatorit njëvjeçar të kaskadës së Drinit.

Miratimi i këtij projektvendimi do të mundësojë sigurimin e financimit në shumën e 40 milionë eurove me përfitues KESH-in. Unë shpresoja që sot vërtet të kishim një debat të qenësishëm, por më vjen keq që nga ana e opozitës shikoj vetëm një deputet. Kjo tregon edhe interesin e të gjithë deputetëve të opozitës për një çështje kaq të rëndësishme për një sektor kaq të rëndësishëm.

Të falënderoj, Lindita, që je prezente këtu! Kjo tregon edhe seriozitetin e opozitës në një diskutim kaq të rëndësishëm, kur flitet për energjinë dhe jo vetëm thjesht për një hua. Shpresoj vërtet që, pavarësisht nga mungesa e tyre këtu, për arsye të investimit kaq strategjik për Shqipërinë dhe për sektorin e energjetikës, të gjithë deputetët, edhe të opozitës, të cilët mungojnë në këtë sallë, ta aprovojnë atë. Faleminderit!